



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM

Nr 115 Datë 31. 10. 08

PER

**Miratimin e shpenzimeve operative për institucionin e Menaxhimit të
Projekteve (PIU)**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës **“Për miratimin e shpenzimeve operative për institucionin e Menaxhimit të Projekteve (PIU)”**, bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr. 9836 dt. 26.11.2007 «Për buxhetin e Shtetit të vitit 2008», Udhëzimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F «Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008», Udhëzimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrisë së Brendshme «Për zbatimin e buxhetit të qeverisjes vendore për vitin 2008 », V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008», Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë» dhe VKB nr 81 dt. 19.09.2008 “Mbi ndryshimin e strukturës për krijim institucioni në vartësi” mbështetur në kompetencat që ka, mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë shpenzimet operative për institucionin e Menaxhimit të Projekteve (PIU) të detajuara si më poshtë :

▪ Shërbime komunale (energji elektrike, ujë)	36,000-lekë
▪ Shpenzime kopjimi dhe printimi	45,000-lekë
▪ Shpenzime telefonike	36,000-lekë
▪ Shpenzime karburanti	75,000-lekë
▪ Të tjera	57,600-lekë
Shuma	249,600-lekë

2. Fondi i llogaritur për periudhën 1 tetor deri me 31 dhjetor 2008 në vlerën prej 249,600-lekë, do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet Bashkia	00	04980	05	Art 6090000 -	249,600
Shtohet (PIU)	00	01110	05	Art 6020000 +	249,600

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike si dhe Institucioni i Menaxhimit të Projekteve (PIU)

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase

Raimonda Nase

Dixhitalizuar nga Qendra e Informacionit
www.infocip.org